



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 2017 Prot.

Tiranë, më 09.12 2022

Lënda: Për publikimin e njoftimit për fillimin e procedurave të përzgjedhjes së një anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
TIRANË

QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE
TIRANË

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës, në mbështetje të neneve 47 dhe 48 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të pikës 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë", shpall thirrjen për:

- **Fillimin e procedurave të përzgjedhjes së 1 (Një) anëtari të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, që përzgjidhet nga studentët e Universitetit të Tiranës**

Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë, është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Funkzionet kryesore të Bordit Administrativ, janë:

- a) Garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij;
- b) Me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
- c) Me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
- d) Vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- dh) Miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të institucionit të arsimit të lartë.
- e) Jep mendimin për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
- f) Përzgjedh rregullat e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
- g) Është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorit dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
- h) Emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
- i) Miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se ti përcillet Senatit Akademik;
- j) Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit të hartuar nga rektorati.

Kriteret për t'u emëruar anëtar i Bordit të Administrimit, janë;

- a) Të ketë integritet etik dhe profesional
- b) Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake
- c) Të mos jetë i denuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave

Aplikimi për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes së 1 (Një) anëtarit të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, duhet të përmbajë:

- Kërkesë për pjesëmarrje në konkurrim,
- Jetëshkrim, ku ndër të tjera të përshkruhen arritjet në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Arritjet e referuara nga aplikanti, në një apo disa nga këto fusha, të shoqërohen me kopje të noteruara të dokumenteve provuese.
- Kopje të dokumentit të identifikimit,
- Kopje të noteruar të Diplomës së arsimit të lartë
- Kopje të noteruar të diplomës/certifikatës/dëshmisë së nivelit më të lartë të kualifikimit shkencor dhe/ose akademik.
- Vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore, sipas formularit bashkëlidhur,
- Vetëdeklarim për kushtet e konfliktit të interesave, sipas formularit bashkëlidhur.

Dokumentet për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes së 1 (një) anëtarit të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve, do të dërgohen përmes shërbimit postar, në adresën:

*Universiteti i Sporteve të Tiranës
Komisionit Institucional të Zgjedhjeve,
Tiranë.*

Afati për dorëzimin e dokumentacionit fillon më datë: 19 Dhjetor, deri më 23 Dhjetor 2022. Lista paraprake e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart, do të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, brenda datës 27 Dhjetor 2022. Procesi i shqyrtimit të ankesave do të zhvillohet me datë 29.12.2022. Lista përfundimtare e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në VKM nr.782, datë 26.12.2018, të referuar më lart, do të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Sporteve të Tiranës, brenda datës 29 Dhjetor 2022.

Data e votimit të studentëve për përzgjedhjen e kandidaturave që do t'i paraqiten Ministrit të Arsimit dhe Sportit për emërimin e anëtarit të Bordit të Administrimit të Universitetit të Sporteve, përfaqësues të studentëve 12 Janar 2023.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

KRYETARI

Denis NURIU

REKTORI
Prof.Dr. Agron KASA